



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TE DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së	NSH "Rilindja" Rrjeti Tregtar- Librar Prishtinë ("Ndërmarrja")
Emri i Ndërmarrjes së Re	NSH "Rilindja" Zona Industriale SH.P.K. ("Ndërmarrja ")
Vendndodhja	Prishtinë
Biznesi/Spektori	Libra dhe material shkollor
Prodhimet	NSH ka shitur libra, material shkollor dhe material për zyrë. Aktualisht, Ndërmarrja operon me disa njësi të veta si shitore të librarisë "Rilindja".
Tregu	Ndër. e Re me lokacionin e saj strategjik ofron mundësinë për të zhvilluar aktivitete komerciale dhe të qiradhënies.
Konkurrenca	Aktualisht tregu është mjaft konkurrues, pasi që në vitet e fundit në Kosovë ka pasur rritje të konsiderueshme të qiradhënies të pronave dhe aktiviteteve komerciale.
Ndërtesat dhe tokat	Ndërmarrja e Re Rilindja Zona Industriale SH.P.K. i ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e tokës me një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 1 ha 23 ari 31 m ² (12,331 m ²) dhe dy ndërtesa komerciale me sipërfaqe totale prej përafërsisht 2,105 m ² , që gjendet në Zonën Industriale të Prishtinës.
Detyrimet që do të barten:	<ol style="list-style-type: none">(1) Detyrimet neto të NSH-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;(2) Detyrimet e papaguara të NSH-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;(3) Detyrimet e NSH-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;(4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSH-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

qe:

- a) Është mbledhur gjate periudhës tre mujore qe përfundon ne datën kur deklarata relevante e transferit ka hyre ne fuqi;
- b) Qe mbetet e papaguar deri ne atë date dhe i ngarkohet biznesit te NSH-se.

Shikim parcial i Ndër. Re



Informata

Departamenti për Shitje

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet për Ofertë

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Rruga Ilir Konushevcu Nr. 8

10000 Prishtinë/Pristina, Kosovo

Rr. Rexhep Mala nr.2
10000 Prishtinë, Kosovë,
Tel: 038 226 889,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org